

## LUTJE ZOJËS RRUZARE TË POMPEIT

Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit t' Shenjt. Amen.

O e madhërueshmja Mbretëreshë e Fitoreve, o Mbretëreshë e qiellit dhe e tokës, para emrit tënd gazmojnë qiejt e dridhen thellësitë, o e lavdishmja Mbretëreshë e Rruzares, ne bijtë e tuaj të devotshëm, të mbledhur në tempullin tënd të Pompeit (në këtë ditë të madhe\*) po i zbrazim ndjesitë e zemrës sonë dhe me besim bijsh po ti shprehim mjerimet tona.

Prej Fronit të butësisë tënde, ku rrin si Mbretëreshë, sille o Mari shikimin tënd të dhimbshëm, mbi ne, mbi familjet tona, mbi Shqipërinë, mbi Europën dhe mbi botën. Ke dhimbje për vuajtjet e trazimet që e kanë mbuluar jetën tonë. Shih o Nënë, sa rreziqe në shpirt e në trup, sa fatkeqësi e pikëllime po na shtrëngojnë.

O Nënë, lyp mëshirë për ne prej Birit tënd Hyjnor e fitoji me butësinë tënde zemrat e mëkatarëve. Janë vëllezërit tanë e bijt e tuaj që i kushtojnë gjak të ëmbëlit Jezus dhe e trishtojnë zemrën tënde aq të ndiejshme.

*Të falemi Mari.*

(\*) *Thuhey vetem ne 8 Maj e te djelen e pare te tetorit.*

Është e vërtetë që jemi ne të parët të cilët, megjithëse bij të tuaj, me mëkatet tona e kryqëzojmë në zemrat tona të dashturin tonë Jezusin dhe përsëri e therim zemrën tënde.

E themi haptas: meritojmë ndëshkimet më të rënda, por ti kujtohu se në Mal të kalvarit more me gjakun hyjnor besëlidhjen e Shëlbuesit që po vdiste, që të quejti Nënë tonë, nënë të mëkatarëve. Ti pra si nënë e jona, je mbrojtja jonë e shpresa jonë. Dhe ne duke rënkuar i drejtojmë në lutje duart tona duke bërëtitur : Mëshirë.

O nënë e mirë, ki dhimbje për ne, për shpirtërat tanë, për familjet tona, për të dashurit tonë, e sidomos për armiqtë tonë e për ata që quhen të krishterë por e fyejnë zemrën e ëmbël të Birit tënd.

Dhimbsuri kërkohet sot për kombet e shqetësuara, për mbarë Evropën, për tërë botën, që të penduar të kthehen në Zemrën tënde.

*Të falemi Mari*

Denjohu me mirësinë tënde o Nënë e ndigjoje lutjen tonë. Jezusi i ka lëshuar në dorën tënde të gjitha thesaret e Hireve të veta e të Mëshirës së vet.

Ti rrin, Mbretëreshë e kurorëzuar në të djathtën e Birit tënd duke shndritur me dritën e pavdekshme mbi të gjitha çetat e engjëjve. Ti e shtrin sundimin tënd mbi sa janë të shtrirë qiejt e i ke nën sundimin tënd tokën dhe të gjitha krijesat.

Ti prej hirit të Zotit je e gjithëpushtetshme, ti pra mundesh me na ndihmuar. Nëse ti nuk don të na ndihmosh pse jemi bij mosmirënjohës që s'e meritojmë mbrojtjen tënde, ne nuk dimë kujt ti drejtohemi. Zemra jote Nënë s'do të lejojë që të shohësh ne, bijtë e tu, të humbur. Fëmijën që shohim mbi gjunjët e tuaj dhe rruzarja e shenjtë që ne e shohim në dorën tënde, na jep shpresë së do të na ndigjosh. E ne kemi besim të plotë në ty e po lëshohemi si bij të ligsh të në krahët e më të dashurës ndër nëna, e po sot nga ti i presim hirit e dëshirueshme.

*Të falemi Mari*

### **Kërkojmë bekimin e Zojës Mari**

Në fund një hir të kërkojmë, o Mbretëreshë, që nuk mund të na e mohosh (në këtë ditë të madhe\*). Na jep dashurinë tënde të qëndrueshme e sidomos bekimin tënd prej nëne.

Nuk do të ndahemi nga ti deri sa t'mos na kesh bekuar. Bekoje o Zoja Mari, në këtë moment Papën e Shenjt. Shkëlqimeve të hershme të Rruzares tënde prej nga ti quhesh Mbretëreshë e fitoreve, shtoi edhe këtë: Jipe fitoren e Fesë dhe paqen në mbarë njerëzimin. Bekoji Ipeshkvinjtë tanë, meshtarët e veçanërisht të gjithë ata që jipen mbas shërbimit të shejtnores tënde. Bekoji më në fund të gjithë anëtarët e tempullit tënd të Pompeit dhe të gjithë ata që e ushtrojnë dhe e përhapin devotshmërinë e Rruzares së Shenjtë.

O Rruzare e bekuar e Zojës. Varg i ëmbël që lidh me Zotin. Lidhje dashurie që na bashkon më Engjëjt. Mburojë shpëtimi kundër sulmeve të Ferrit. Liman i sigurt shpëtimi në det, ne nuk do të braktisim kurrë.

Ti do të na jeshë ngushëllim në orën e vdekjes, ty puthjen e fundit të jetës që shkon. Fjala e fundit e buzëve tona do të jetë emri i këndshëm i yti, o Mbretëreshë e Rruzares së Pompeit. O Nënë e dashtur e jona, o strehë e mëkatarëve, o Mbretëreshë ngushëlluese e të trishtuarve.

Qofsh kudo e bekuar, sot e përgjithmonë në tokë e në qiell. Amen.

*Falemi Mbretëresha.*

(\* ) Thuhey vetem ne 8 Maj e te djelen e pare te tetorit.